



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor

Mbledhja nr. 38

Prishtinë, më 10.5.2016, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Në mbledhje morën pjesë : Duda Balje, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Srdjan Popoviq,
Emilija Redzeqi, Shaip Muja.

Munguan : Haxhi Shala, Salih Salihu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi **Duda Balje**, kryetare e komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 13.4.2016,
3. Shqyrtimi i raportit vjetor i agjencisë për komplekset memoriale,
4. Te ndryshme ;

Kryesuesja **Duda Balje** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 13.4.2016

Procesverbali nga data 13.4.2016 u miratua pa vërejtje dhe me shtesën e dërguar nga Murat Hoxha rreth diskutimit të tij.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor nga Agjencia për komplekset memoriale

Kryesuesja përshëndeti dhe falënderoi për pjesëmarrje drejtorin e agjencisë **Idriz Blakaj** i cili në fillim potencoi se tanimë ky agjenci ka zgjedhur problemin e lokalit-zyreve dhe të automjeteve duke shprehur siç tha ai se do të zgjidhen edhe problemet tjera siç është kompletimi me stafin, ngase funksionimi i agjencisë me vetëm 11 zyrtar do të shndërrohet në vështirësi permanente. Problemet tjera të agjencisë sipas tij janë problemet financiare në bazë të të cilave nuk po mundet agjencia të eliminoi problemet sidomos rreth projekteve ku duhet me angazhua kompani të ndryshme, sidomos urgjente është angazhimi edhe i 4 ciceronëve nëpër komplekset që janë të vizituara më tepër se tjerat. Për shkak të mungesës financiare ai potencoi edhe vështirësinë e hartimit të strategjisë së agjencisë e cila kërkon njerëz profesionist dhe ekspert të lëmisë dhe numëroi komplekset një nga një ku dhe sa kanë përparua në aspektin e mirëmbajtjes së tyre. Në fund përkujtoi se ky komision është themeluar i agjencisë ndaj kërkoi ndihmë sa i përket kërkesave të lartcekura rreth kompletimit të stafit dhe angazhimit të ciceronëve.

Kryesuesja para se të jap fjalën anëtarëve të komisionit pyeti a kanë dorëzuar raportin financiar të rishikuar në bazë të së cilës do të mund të lloboj ky komision dhe sa ka nevojë kjo agjenci për staf. Përgjigja ishte se kjo agjenci ka nevojë për 60 zyrtar, por për fillim jo edhe aq ngase kjo arrihet shkallë shkallë, ndërsa për raportin financiar drejtori tha se nuk ka ardhur koha ende, por kjo duhet të bëhet së shpejti nga ana e agjencisë. **Adem Salihaj** u ndërlidh me gjendjen fillestare kur është themeluar kjo agjenci me shumë vërejtje dhe sugjerime, por tani siç po shihet konsolidimi po bëhet edhe pse me hapa të ngadalshëm, zyrtarët e agjencisë, vazhdoi, duhet të vizitohen komplekset në Kosovë dhe të japin vlerësimin e përgjithshëm për të gjitha komplekset memoriale dhe gjendjen e tyre, p.sh. në Ferizaj ka nevojë për përkujdesje profesionale dhe organizim të mirëfilltë. Lidhur me plotësimin e agjencisë me staf tha se ka fituar bindjen se aty ka më tepër shefa sesa zyrtar të rëndomtë-puntorë, njihurit pyeti për disa komplekse dhe gjendjen e tyre dhe a ka gjasa të përfundojnë. Për kërkesat e agjencisë sugjeroi të hartohen me shkrim dhe të dërgohen në komision si për mjete ashtu edhe për staf për të pasur më lehtë komisioni me lobue. Ai plotësisht mbështeti kërkesën rreth plotësimit të stafit me ciceron-guida, ngase këta zyrtar e bëjnë gjallë historinë dhe pyeti pse agjencia është fokusuar gjithsesi në disa projekte siç është Prekazi, Marina etj por nuk mbështeti hyrjet me pagesë ngase ende nuk janë krijuar kushtet për një gjë të tillë dhe nuk tingëllon mirë. Z. Salihaj përfundoi duke kërkuar përfshirjen e të gjitha periudhave historike për të mos humb vlera e njerëzve apo heronjve siç është p.sh. Mic Sokoli duke ju rit vlerën përmes ndërtimit të komplekseve, ngase

është një arsye e thjeshtë e ajo është se nuk kemi libra të shkruara-dokumente. Drejtori u përgjigj se projektet janë të përcjellura nga MMPH ndaj ato duhet ti përfundoi agjencia, ndërsa rreth stafit tha se ata që kanë ardhur nga MMPH agjencia nuk ka mund ti degradoi dhe shtoi se është i kënaqun me stafin ekzistues. Gjithashtu njoftoi për projektet ekzistuese detalisht dhe shtoi se kullat janë më urgjente sepse janë në gjendje të keqe duke u shkatërruar, MFE vazhdimisht po njofton agjencinë për mungesën e mjeteve financiare etj. **Murat Hoxha** potencoi mbi të gjitha planifikimin për shkak të rëndësisë që ka dhe arsyetoi kërkesën për staf ngase me 11 zyrtar është e pakuptim të funksionoi agjencia, ai premtoi mbështetje dhe përpjekjet për hartimin e strategjisë kurse drejtori tha se nuk është çështja se janë tepër modest lidhur me kërkesat por janë në pyetje mungesat e shumta ndërsa për planifikim potencoi faktin se nuk janë mar parasysht kërkesat e tyre. **Shaip Muja** gjithashtu u bashkëngjiti kërkesës që agjencia të njoftoi me shkrim më detalisht për kërkesa dhe donacione por jo bileta, si tha ai, përndryshe edhe poçes janë mjetet, mirëmbajtja duhet të ekzistoi.

Komisioni rekomandoi miratimin e raportit në mbledhjen plenare.

4. Të ndryshme

Në pikën vijuese Kryesuesja propozoi **shqyrtimin dhe rekomandimet si në vijim :**

- Caktohen deputetët **Shaip Muja** dhe **Murat Hoxha** për pjesëmarrje në grupin punues të caktuar nga komisioni për buxhet rreth projektligjit për Obiliqin,
- Të dërgohet rekomandimi mbledhjes plenare për kërkesën e komisionit që Qeveria të marr përsipër hartimin e Ligjit për shpronësime sipas shkresës së përgatitur nga kryesuesi i GP z. Murat Hoxha,
- Të kërkohet përmes mbledhjes plenare nga Qeveria kompletimi i listës së bordit për mjedis për shkak se njëri nga anëtarët e propozuar është dorëhequr,
- Të rishpallet konkursi për zëvendës drejtor në Autoritetin rregullatorë për shërbimet e ujit,
- Në mbledhjen e radhës të ftohet përfaqësuesi i Autoritetit të shërbimeve të ujit për raportin për vitin 2015.

Mbledhja përfundoi në orën 13,00.

Përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Duda Balje